



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.797/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Donjetë Morina kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e paneli të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë,

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Donjetë Morina kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjën ZL.Anr.797/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, në Vendvotimet: 1009D/01R, 1009D/02R, 1009D/03R, 1009D/04D, 1001D/01R, 1001D/02R, 1001D/03R, 1001D/04R, 1001D/05R, 1001D/06D, 1001X/01R, 1001X/02R, 1001X/3R, 1001X/04R, 1001X/05R, 1024D/01R, 1024D/02R, 1024D/03R, 1024D/04D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.797/2017 me datën 09.11.2017 në ora 19:00, nga parashtruesi Donjetë Morina kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kamenicë, në të cilën pretendohet se në QV1009D dhe QV 1009D VV 01, 02, 03, dhe 04 në fshatin

Rogaqicë, në 1009D/01R ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave duke u bartur votat nga kandidatja me 15 tek kandidatët tjerë të njëjtit subjekt politik, në këto qendra të votimit: Shkollafillore, "Ismail Qemajli", 1001D/01R, 1001D/02R, 1001D/03R, 1001D/04R, 1001D/05R, 1001D/06D, Shkolla Teknike "Andrea Duresaku", 1001X/01R, 1001X/02R, 1001X/01\3R, 1001X/04R, 1001X/05R, 1024D/01R, 1024D/02R, 1024D/03R, 1024D/04.

Parashtruesi i apelit si provë ka bashkangjitur raportin e auditimit të QNR-së dhe FRK-të.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojnë edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe paneli e miratoj apelin duke u bazuar në nenin 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*. Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.797/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i*.